



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pranuar - Përfjeto Më/Dana 09-02-2024 vitet

Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetësi Prilog	Vlera Vendoset
02-	035	02-	134



## MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMUNAL

Palët nënshkruese të marrëveshjes

Komuna Klokot Dhe Komuna Vitisë

Palët u pajtuan për arritjen e bashkëpunimit ndërkomunal në fushën e ofrimit të shërbimeve profesionale.

Duke marrë parasysh bashkëpunimin në fushën e ofrimit të shërbimeve të një zyrtari të certifikuar për kryerjen e Prokurimit Publik, z. Burim Sadiku.

Duke pranuar se pjesëmarrja në një aktivitet të tillë është vullnetare dhe përfshin bashkëpunim dypalësh ndërkomunal mbi baza të barabarta.

Duke pasur parasysh Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 Neni 28, Ligji për Bashkëpunim Ndërkomunal nr. 04/L-010 Neni 5 dhe 8.

Neni 1.

Baza ligjore Kjo marrëveshje e bashkëpunimit është bazuar në Ligjin e vetëqeverisjes lokale nr. 03/L-40 neni 58 dhe Ligjin mbi bashkëpunimin ndërkomunal nr. 04/L-010 neni 5 dhe 8.

Neni 2.

Qëllimi i bashkëpunimit është: ofrimi i shërbimeve profesionale të një zyrtari të certifikuar për prokurim publik Bashkëpunimi do të zbatohet mbi bazën e përfitimit të njëanshëm.

Neni 3.

Objekti i marrëveshjes

Objekti i kësaj marrëveshjeje është: ofrimi i shërbimit të një zyrtari të certifikuar për kryerjen e aktiviteteve të prokurimit publik në periudhën kohore deri në revokimin e këtij memorandum apo deri në certifikimin e zyrtarit komunal, sepse komuna e Klokotit ka një zyrtar por ai nuk është i certifikuar dhe nuk ka qasje në punë në sistemin e prokurimit ku i njëjti zyrtar komunal merr rrogë por nuk mundet të kryejnë shërbime në sistem.

Neni 4.

Të drejtat dhe detyrimet e secilës palë të përfshirë në marrëveshje Të drejtat dhe pbligimet e komunës së Klllokotit:

1. Sigurimi i të gjitha dokumenteve për kryerjen e detyrimeve të punës lidhur me kryerjen e punës së prokurimit publik.
2. Ofrimi i shërbimeve teknike për kryerjen e punëve në prokurim.
3. Dhënja e pëlqimit për qasje në sistem.

Të drejtat dhe pbligimet e komunës së Vitisë:

1. Ofrimi i shërbimeve në fushën e prokurimit publik përmes angazhimit të zyrtarit komunal për prokurim publik z.Burim Sadiku.

Neni 5.

Burimet financiare Ofrimi i shërbimit ndërmjet palëve do të jetë pa pagesë

Neni 6.

Zgjidhja e marrëveshjeve Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve ose zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet me marrëveshje të një arbitri ose një gjykate kompetente.

Neni 7.

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërkomunal hyn në fuqi më datën e nënshkrimit. Kjo marrëveshje është bërë në gjashtë (6) kopje origjinale, ku secila palë kontraktuese merr tre (3) kopje origjinale.

Datë: 08.02.2024.

Komuna Klllokot

Kryetari

Vlladan Bogdanovic



Komuna Vitisë

Kryetari

Sokol Haliti

